



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina



EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

Nga Dëgjimi i përgjithshëm publik, mbajtur më 23.7.2026 i cili filloi në orën 14:00

Të pranishëm ishin: - drejtoresha nga Drejtoria e Financave - Valbona Makolli; shefi i investimeve kapitale - Liridon Shahini; drejtori i Drejtorisë së Kulturës - Isah Mustafa; drejtori i Drejtorisë së Administratës - Driton Bardheci; drejtoresha nga Drejtoria e Bujqësisë - Jeta Rafuna; drejtori nga Drejtoria e Sportit - Granit Geci; drejtori nga Drejtoria e Mobilitetit - Pëllumb Bajqinovci; drejtori nga Drejtoria e Arsimit - Arianit Elshani; drejtoresha nga Drejtoria e Parqeve - Albana Gjonbalaj; drejtori nga Drejtoria e Shërbimeve Publike - Leotrim Retkoceri.

Osman Billaca: - tha se në këtë pjesë hapet dëgjimi i katërt buxhetor, i organizuar kryesisht për kryetarët e bashkësive lokale. Pjesëmarrësit njoftohen se, megjithëse takimi është planifikuar për këtë kategori, nuk ka kufizime në paraqitjen e kërkesave dhe secili mund të bëjë propozime ose kërkesa të çdo natyre.

Osman Dragusha, kryetar i Këshillit Lokal të Prugocit: - në emër të pesë lagjeve të Prugocit, prezantoi kërkesat dhe nevojat kryesore të banorëve, të cilat më herët ishin diskutuar edhe në një takim tjetër. Ai u ndal në mënyrë të veçantë te kërkesat sipas drejtorive komunale, me shpresën që ato të realizohen në të ardhmen. Nga Drejtoria e Investimeve Kapitale u kërkuar asfaltimi ose shtrimi me kubëza i rreth 2 km rrugica në lagjen e parë. Gjithashtu u kërkuar përfundimi i punimeve në rrugën Bardhosh – Prugoc dhe vazhdimi i saj deri te ura që lidh Prugocin me Barilevën. U theksua se kjo rrugë paraqet problem të madh për banorët për shkak të mosfunksionimit të kolektorit dhe kanalit të hapur të ujërave të zeza, i cili shkakton kundërmim dhe vështirësi në jetesën e përditshme. Gjithashtu nga Drejtoria e Infrastrukturës u paraqitën kërkesa për rregullimin e trotuarit me gjatësi rreth 1 km në lagjen e parë, sanimin e dëmtimeve të rrugëve nga xhamia dhe brenda lagjes së dytë, vendosjen e shiritave ngadalësues pranë shkollës fillore “Nexhmi Mustafa” në Prugoc, si dhe rregullimin e dy stacioneve të autobusëve në lagjen e katërt. Për Drejtorinë e Shërbimeve Publike u kërkuar pastrimi dhe rregullimi i një sipërfaqeje prej rreth 6 hektarësh pronë komunale në lagjen e parë, e cila nga

një hapësirë rekreative është shndërruar në deponi mbeturinash. Po ashtu u kërkuar vendosja e ndriçimit publik në rreth 20 rrugica të lagjeve 3, 4 dhe 5, pasi disa zona nuk ishin përfshirë në investimet e mëparshme. U kërkuar që të korrigjohen këto mangësi dhe të gjithë banorët të trajtohen në mënyrë të barabartë. Gjithashtu u kërkuar rrethimi i varrezave në lagjen e parë për mbrojtje, mirëmbajtje dhe krijim të kushteve më të mira për qytetarët. Për Drejtorinë e Arsimit u kërkuar ndërtimi i objektit të ri të shkollës “Nexhmi Mustafa” në Besi, duke theksuar se kjo shkollë me traditë mbi 100-vjeçare është në gjendje të dobët, me mungesë të infrastrukturës së brendshme, sallës së edukatës fizike dhe kushteve të përshtatshme në ambientin e jashtëm. Po ashtu u kërkuar ndërtimi i sallës sportive në Prugoc dhe renovimi i hapësirave të brendshme të shkollës, ku prej disa vitesh nuk janë bërë ndërhyrje (theksohet se rreth 160 nxënës kanë nevojë për kushte më të mira për zhvillimin e aktiviteteve sportive). Njëherazi për Drejtorinë e Kadastrit u ngrit problemi i emërimit të disa rrugëve dhe mungesës së numrave të shtëpive, si dhe u kërkuar korrigjimi i emërimeve të vendosura gabimisht dhe përcaktimi i emrave të rrugëve sipas kërkesave të banorëve. Për Drejtorinë e Mobilitetit u kërkuar zgjidhje për problemin e transportit publik në lagjen e parë, duke theksuar se banorët detyrohen të zbresin në Besi dhe të ecin rreth 1 km deri në lagje, edhe pse linjat ekzistuese kalojnë afër zonës. Kjo gjendje prek nxënësit, studentët, pensionistët dhe të gjitha kategoritë e banorëve, kurse si alternativë u propozua zgjatja e linjave të autobusëve deri te rrethi që është në ndërtim, ku do të mund të bëhej kthimi i autobusit dhe vazhdimi i linjës drejt Barilevës. Në fund, Osman Dragusha falënderoi pjesëmarrësit dhe shprehu shpresën që këto kërkesa të mos mbeten vetëm të evidentuara, por të marrin zgjidhje konkrete për përmirësimin e jetës së banorëve të Prugocit.

Dren Shahini - qytetar i lagjes “Mati 1”: - shprehu pakënaqësi për mungesën e ndryshimeve pavarësisht ndërrimit të vazhdueshëm të drejtorëve komunalë. Ai kritikoi mungesën e përfaqësuesve institucionalë në dëgjimet publike dhe mosadresimin e kërkesave të banorëve. Theksoi se problemet e lagjes “Muharrem Fejza” vazhdojnë prej vitesh, si mosvazhdimi i rrugës kryesore, mungesa e ndriçimit publik dhe rrugët e dëmtuara. Ai ngriti shqetësimin për aneksin e shkollës “Pavarësia”, i cili ende nuk ka pranimit teknik, edhe pse nxënësit zhvillojnë mësimin aty. Tutje ai kërkonte përmirësim të menaxhimit të mbeturinave, vendosjen e më shumë kontejnerëve dhe shmangien e ndotjes nga shërbimet joefikase. Theksoi se kjo lagje është ndër më të mëdhatë në Prishtinë dhe kërkon trajtim të veçantë për shkak të numrit të madh të banorëve. Ai kërkonte decentralizim të aktiviteteve kulturore, krijimin e qendrave kulturore për të rinj dhe të moshuar, si dhe sigurimin e lokaleve për bashkësitë lokale. Gjithashtu ngriti shqetësimin për mungesën e mirëmbajtjes së pushtave dhe problemeve gjatë reshjeve. Ai kritikoi neglizhencën institucionale dhe kërkonte që kërkesat e qytetarëve të merren seriozisht. Në fund kërkonte përmirësim të transportit publik, krijimin e kushteve më të mira për pritjen e autobusëve dhe trajtim më dinjitoz për qytetarët.

Sadedin Hasani - kryetar i Këshillit lokal Qendra: - paraqiti kërkesat e banorëve për përmirësimin e jetës dhe shërbimeve publike në këtë zonë. Ai falënderoi për punimet e realizuara dhe kërkonte që projektet e ardhshme të merren parasysh në planifikimin buxhetor. Kërkonte ndarje buxhetore prej 50.000€ për Këshillin lokal Qendra dhe investime në efikasitetin energjetik të

ndërtesave banesore. U kërkua fasadimi i ndërtesave kolektive, veçanërisht në “Sheshin Skënderbeu” dhe objektet historike, si dhe lirimi dhe rregullimi i hapësirave publike me kubëza. Ai ngriti shqetësimin për gjendjen e infrastrukturës nëntokësore në rrugët “Simon Shiroka” dhe “Nurie Zeka”, si dhe problemet me kanalizimin në Sheshin “Rexhep Luci”. Mandej kërkoi trajtimin e garazhave të vjetra në rrugën “Sylejman Vokshi” dhe rregullimin e lagjes “Universiteti”. Për sigurinë publike kërkoi vendosjen e kamerave inteligjente, hidranteve, sinjalistikës emergjente, ndriçimit LED dhe përmirësimin e ndriçimit të tuneleve. Nga Drejtoria e Shërbimeve Publike u kërkua krijimi i qasjes për persona me aftësi të kufizuara, renovimi dhe testimi i sigurisë së ashensorëve në disa ndërtesa kolektive. Gjithashtu u kërkua vendosja e kontejnerëve nëntokësorë, mbjellja e pemëve dhe pastrimi i grafiteve duke i zëvendësuar me murale artistike. Për Drejtorinë e Arsimit u kërkua ndërtimi i objektit të ri për çerdhen “Buzëqeshja”, krijimi i këndeve të lojërave dhe hapësirave për aktivitete të rinjve, pensionistëve dhe organizatave lokale. Qëllimi kryesor i këtyre kërkesave është krijimi i një Qendre më të sigurt, më të pastër, më të gjelbër dhe me standarde më të larta jetese.

Xhemajl Aliti - përfaqësues nga fshati Ballaban: - paraqiti shqetësimet e banorëve për mungesën e investimeve në infrastrukturë dhe problemet me bujqësinë. Ai theksoi se prej 15 vitesh kërkohet ndërtimi i një rruge prej rreth 1.3 km që lidh shtëpitë e banorëve me asfaltin, por deri tani nuk është realizuar. Rruga është në gjendje shumë të keqe, sidomos gjatë dimrit, duke krijuar vështirësi për nxënësit që shkojnë në shkollë dhe rrezik për banorët. Ai kërkoi që komuna ta vizitojë gjendjen në terren dhe ta bëjë rrugën të paktën të kalueshme. U theksua se Ballabani është një fshat me potencial turistik, me liqen dhe zhvillim të vikendicave, por mungesa e infrastrukturës pengon zhvillimin e tij. Si fermer, ai ngriti edhe problemet në sektorin e bujqësisë, duke theksuar vështirësitë në shitjen e qumështit dhe mishit, si dhe çmimet e ulëta të grurit. Ai deklaroi se fermerët nuk kanë treg të sigurt për produktet e tyre dhe përballen me vështirësi ekonomike. Në fund, kërkoi nga drejtoria përgjegjëse që të dalë në terren, të shohë gjendjen reale të rrugës dhe të ndërmerren masa konkrete për zgjidhjen e problemeve të banorëve të Ballabanit.

Adem Sulejmani - kryetar i Këshillit lokal “Kodra e Trimave II”, paraqiti kërkesat dhe shqetësimet kryesore të banorëve për përmirësimin e kushteve të jetesës në këtë lagje. Ai falënderoi drejtorët e rinj dhe kërkoi që çështjet e ngritura të trajtohen me prioritet, pasi shumica janë probleme të përditshme të qytetarëve. Në fushën e infrastrukturës rrugore, ai theksoi se “Kodra e Trimave” përballlet me probleme të shumta dhe kërkoi ndërhyrje urgjente në disa segmente rrugore. Ai propozoi krijimin e zgjidhjeve alternative të qarkullimit, lidhjen e rrugës “Shefki Desivojca” me rrugën “27 Nëntori”, si dhe trajtimin e rrugës “Asllan Pireva” dhe “Rrugës së Artës”. Gjithashtu kërkoi rregullimin e rrugës “Besnik Lajçi”, e cila sipas tij nuk ka infrastrukturë bazë dhe është zgjeruar si pasojë e rritjes së lagjes. Për ndriçimin publik u theksua se mbi 150 rrugica të “Kodra e Trimave” kanë probleme me ndriçimin. Ai kërkoi që të bëhet një identifikim në terren dhe të ndërmerren masa për rregullimin e sistemit të ndriçimit. Sa i përket menaxhimit të mbeturinave, ai ngriti shqetësimin për gjendjen e rënduar dhe kërkoi një zgjidhje të qëndrueshme dhe të organizuar, jo vetëm ndërhyrje pas ankesave të banorëve. Ai falënderoi drejtorin për ndihmën e dhënë, por kërkoi një sistem më funksional të menaxhimit të mbeturinave. Një shqetësim tjetër ishte furnizimi me ujë, pasi lagja përballlet me ndërprerje dhe reduktime të shpeshta, si dhe kërkoi që komuna të bashkëpunojë me ujësjellësin rajonal

për zgjidhjen e këtij problemi. Gjithashtu ngriti problemin e kanalizimeve dhe vërshimeve, veçanërisht në zonën e Zenel Hajdinit, ku reshjet shkaktojnë hyrjen e ujit në shtëpitë e banorëve. Në aspektin e sigurisë në trafik, kërkoi vendosjen e masave fizike për uljen e shpejtësisë në rrugët kryesore, sidomos në drejtim të Podujevës, si dhe përmirësimin e sinjalistikës në rrugën “Mic Sokoli”. Për hapësirat publike kërkoi informacione për projektin e ndërtimit të një parku pranë shkollës “Zenel Hajdini” dhe kërkoi që banorët të njoftohen për fazën ku ndodhet ky projekt. Nga Drejtoria e Arsimit kërkoi ndërtimin e një objekti parashkollor në kuadër të shkollës “Zenel Hajdini”. Po ashtu nga Drejtoria e Sportit kërkoi ndërtimin e një qendre multifunksionale me hapësira sportive, edukative dhe rekreative për të rinjtë dhe komunitetin. Ai kërkoi gjithashtu sqarime për planin e regjenerimit ose masterplanin për “Kodrën e Trimave”, duke kërkuar informacione për fazën aktuale dhe hapat e ardhshëm të realizimit. Në fund, kërkoi që një rrugë të emërtohet në nder të doktor “Safete Sofia Ukës”, duke theksuar kontributin e saj për çështjen kombëtare shqiptare. Ai përfundoi duke kërkuar që këto çështje të mos mbeten vetëm kërkesa, por të shndërrohen në veprime konkrete nga institucionet.

Kaltrina Rexhepi – fermere nga Komuna e Prishtinës: - falënderoi komunën për mundësinë që fermerët të paraqesin kërkesat dhe propozimet e tyre, duke kërkuar rritjen e mbështetjes për mekanizmin bujqësor, veçanërisht për traktorë dhe pajisje të rënda. Ai propozoi që tokat komunale me qasje në sistemin Ibër-Lepenc t’u jepen në shfrytëzim fermerëve, si dhe kërkoi rritje të mëtejshme të subvencioneve për bletarinë, duke theksuar rritjen e kostove dhe ndikimin e ndryshimeve klimatike. Tutje vlerësoi projektin e tregut mobil dhe kërkoi që ai të vazhdojë në vitin 2027, duke nisur më herët, nga muaji maj. Në fund kërkoi më shumë investime në rrugët rurale, veçanërisht asfaltimin e rrugës “Hashim Hasani” në fshatin Sharban, si dhe propozoi ndërtimin e një parkingu pranë shkollës “Hilmi Rakovica”, për të lehtësuar qarkullimin dhe qasjen e prindërve.

Bashkim Ibrahim – Kryetar i këshillit lokal Bërrnicë e Poshtme dhe Bardhosh: - theksoi se Bardhoshi dhe Bërrnica po rriten vazhdimisht me banorë, por investimet komunale kanë munguar dhe kështu ai kërkoi zgjerimin e rrugës që lidh Bardhoshin me Bërrnicën e Poshtme, duke e cilësuar të rrezikshme për qarkullim. Ai kërkoi asfaltimin e rrugicave lidhëse dhe rregullimin e rrjetit të kanalizimit, përfshirë ndërtimin e kolektorit, po ashtu kërkoi vendosjen e kujdestarisë në ambulancën e Bardhoshit, duke theksuar se shërbimi mungon. Tutje theksoi se shkolla “Anton Zako Çajupi” është e mbingarkuar dhe propozoi ndërtimin e një shkolle të re, si dhe kërkoi rregullimin dhe zgjerimin e ndriçimit publik, për të rritur sigurinë e banorëve, kurse në fund propozoi zgjatjen e linjës së autobusit urban deri te rrethrotullimi në Trudë, për të përmirësuar transportin publik.

Feim Osmani – asamblist: - tha se nuk do të paraqesë kërkesa specifike në këtë dëgjim, pasi ato do t’i rezervojë për seancën me anëtarët e Kuvendit komunal. Ai u bëri thirrje drejtorëve që buxheti i vitit 2027 të ndërtohet mbi kërkesat konkrete të qytetarëve. Theksoi se kryetarët e këshillave lokalë i njohin më së miri nevojat e banorëve dhe duhet të jenë baza e planifikimit të buxhetit. Ai u shpreh se do të ndjekë procesin dhe më pas do të paraqesë kërkesat e tij konkrete.

Vjosa Shkodra – qytetare: - kërkoi nga Drejtoria e Urbanizmit harmonizimin e Planit Rregullativ “Prishtina e Re – Zona Perëndim” me gjendjen faktike në lagjen Dielli. Tutje theksoi se mospërputhja mes planit rregullativ dhe parcelave kadastrale po pamundëson pajisjen e banorëve

me leje ndërtimore. Ajo sqaroi se banorët nuk kërkojnë shpronësim, por zbatim të komasacionit dhe riparcelimit, siç parashihet në vetë planin rregullativ. Në fund kërkoi nga Drejtoria e Financave të parashohë një linjë buxhetore në vitin 2027 për harmonizimin e planit rregullativ me gjendjen në terren.

Remzi Demolli – qytetar: - Kërkoi investime në infrastrukturën rrugore dhe asfaltimin e rrugëve në “Lagjen Demolli” dhe në gjithë fshatin Gllgovicë. Theksoi se gjendja e rrugëve po vështirëson qarkullimin e banorëve, nxënësve, automjeteve dhe fermerëve. Ai kërkoi mbështetje për mekanizëm bujqësor, përfshirë multikultivatorë, minitraktorë dhe pajisje për punimin e tokës. Tha se mbështetja në mekanizëm do të ulte kostot dhe do të ndihmonte zhvillimin e fermave familjare, si dhe kërkoi vazhdimin e projektit të tregut mobil dhe fillimin e tij më herët, në muajin prill ose maj. Theksoi se vonesat në hapjen e tregut mobil ua vështirësojnë fermerëve shitjen e produkteve gjatë sezonit.

Bislim Sylja – kryetar i Bashkësisë lokale në Besi: - tha se kërkesat i ka dërguar edhe më herët me email dhe shkresa zyrtare. Kërkoi ndërtimin e rrjetit të ujësjellësit në Rimanishtë. Përmendi nevojën për trajtimin e rrugëve Siqevë–Rimanishtë dhe Besi–Lebanë–Rimanishtë. Pastaj ngriti shqetësimin për një rrugë në Besi që po punohet pa miratimin e këshillit lokal dhe kërkoi verifikim nga komuna. Gjithashtu kërkoi riparimin e shtyllave dhe vendosjen e ndriçimit publik në Rimanishtë, rrethimin dhe rregullimin e varrezave në Teneshdoll, Vranidoll, Besi dhe Rimanishtë. Po ashtu theksoi shqetësimin për uzurpimin dhe dëmtimin e disa hapësirave të varrezave në Besi dhe kërkoi dalje në terren, si dhe kërkoi verifikim institucional për dëmtimin e varrezave të vjetra në rrugën “Pranvera e Lirisë” dhe rregullimin e tyre si pronë komunale.

Isa Rexha, kryetar i Këshillit lokal të Barilevës dhe Drenocit: – theksoi se kërkesat e banorëve të Barilevës dhe Drenocit janë përsëritur vazhdimisht që nga viti 2024, por nuk ka pasur investime konkrete. Rreth 20 km rrugë kërkojnë asfaltim, ndërsa shumë lagje ende nuk kanë kanalizim, rrugë dhe ndriçim publik. Problemet me kanalet atmosferike dhe vërshimet vazhdojnë të rrezikojnë banorët, veçanërisht në lagjen “Verbovci – Brestovci”, ku kërkohet edhe ngritja e urës mbi Lumin Llap. Afërsisht 50% e fshatit nuk ka ndriçim publik, ndërsa rreth 30% e ndriçimit ekzistues nuk funksionon, pavarësisht kërkesave të dorëzuara në institucionet përkatëse, kurse banorët shprehin mirënjohje për përmirësimin e shërbimit të pastrimit. Edhe pse në buxhetin e vitit 2026 janë paraparë mjete për ndërtimin e çerdhes në Barilevë, projekti nuk ka filluar për shkak të paqartësive rreth lokacionit dhe zbatimit, kështu që banorët janë të pakënaqur me moszbatimin e vendimeve të Asamblesë komunale lidhur me ndarjen e pronës për nevojat e komunitetit, ndërkaq qytetarët janë të revoltuar për vonesën e ndërtimit të çerdhes dhe kundërshtojnë priorizimin e projekteve të tjera para realizimit të këtij projekti.

Ragip Lucolli - kryetar i Këshillit lokal Arbëria 2: - theksoi se problemi kryesor në “Arbëri 2” është mbingarkesa e trafikut në rrugën kryesore të zonës ekonomike, e cila është e stërmshur sidomos gjatë orëve të pikut. Kërkohet ndërtimi i një rruge të re lidhëse nga rruga e Mitrovicës për të lehtësuar trafikun dhe për të mbështetur zhvillimin e zonës ekonomike. Ai përmendi edhe planin e Komunës së Fushë Kosovës për ndërtimin e një rruge përgjatë hekurudhës, e cila do të ndihmonte

në shpërndarjen e trafikut, si dhe kërkoi zgjidhje për aksidentet e shpeshta në kalimet hekurudhore, ku çdo vit ndodhin disa përplasje mes automjeteve dhe trenit. Kërkohet që prioritet t'i jepet realizimit të projektit të rrugës lidhëse, pasi do të përmirësonte qarkullimin dhe do të krijonte kushte më të mira për zhvillimin e zonës ekonomike.

Enes Brahimi: - kërkoi asfaltimin dhe zhavorrimin e rreth 8–10 km rrugë në Prapashticë dhe Keçekollë, për të përmirësuar qasjen e banorëve dhe zhvillimin e turizmit rural, sanimin e hapësirës para memorialit të dëshmorëve në Prapashticë, e dëmtuar nga qarkullimi i automjeteve të rënda. Banorët kërkojnë që dy shkollat e mbyllura të vendosen në funksion ose t'u jepen në shfrytëzim, pasi janë duke u degraduar. Po ashtu kërkoi shtimin e një linje të transportit publik në orën 14:00 për t'iu përgjigjur nevojave të nxënësve dhe punëtorëve. Rreth 12–13 lagje kanë nevojë për ndriçim publik, ndërsa shqetësim i vazhdueshëm mbetet furnizimi i dobët dhe ndërprerjet e shpeshta të energjisë elektrike.

Nuk prezantohet: - kërkoi që kërkesat e qytetarëve për infrastrukturën dhe shërbimet publike të trajtohen me seriozitet dhe të përfshihen në Buxhetin e Komunës së Prishtinës për vitin 2027. “Lagjja Sofali”, rrugët: “Bija”, “UÇK”, “Bislim Makolli” dhe “Voskopja” janë në gjendje shumë të rëndë dhe kërkohet intervenim i menjëhershëm për sanimin e gropave dhe asfaltimin e plotë të tyre. Ai kërkoi që kontrata për sanimin e gropave në këto rrugë dhe në pjesë të tjera të Prishtinës të zbatohet sa më shpejt dhe që rrugët të mos trajtohen vetëm pjesërisht, por të asfaltohen në tërësi. Rruga “Kushtrim Hoxha”, rruga që lidh Toukbashqen me Milleniumin III është dëmtuar rëndë dhe kërkohet asfaltimi i plotë dhe vendosja e ndriçimit publik. Rruga “Xhavit Ahmeti”, “Lagjja Bledi”, punimet kanë mbetur përgjysmë dhe kërkohet përfundimi i tyre. Rruga “Aleks Buda”, është në gjendje shumë të rëndë dhe kërkon ndërhyrje të menjëhershme. Kërkohet që edhe kjo rrugë të përfshihet në buxhetin e vitit 2027. Fshatrat e Gollakut, për këto kërkohet më shumë vëmendje dhe investime në infrastrukturën e këtyre zonave, të cilat sipas kërkesave të banorëve janë lënë pas dore. Rruga “Buna”, rruga që lidh Businë me Slivovën dhe Mramorin, si dhe Gjilanin me Prishtinën, është shumë e ngushtë dhe në gjendje të rëndë. Kërkohet zgjerimi dhe asfaltimi i plotë i saj. Pastaj rruga “Xhavit Gashi”, - “Lagjja Pepaj” në Busi, rruga ka mbetur pjesërisht e shtruar me zhavorr të cilësisë së dobët dhe është dëmtuar. Kërkohet ndërhyrje dhe rregullimi i saj. Busi, Mramori dhe lagjet përreth, sepse gjendja infrastrukturore është alarmante. Shumë lagje nuk kanë ujë të pijshëm, kanalizim dhe ndriçim publik, kurse kërkoi zgjidhje konkrete për furnizimin me ujë të pijshëm, veçanërisht për zonat përreth liqenit të Badovcit, pavarësisht se një pjesë e madhe e Prishtinës furnizohet me ujë nga ky burim. Rruga “Halil Canolli”, Marec - rruga është e asfaltuar vetëm deri te përmendorja e dëshmorit Bastri Canolli, kështu që kërkohet asfaltimi deri në “Lagjen Borovci” dhe shtrimi me zhavorr i pjesës deri në “Lagjen Gjyteti”, me qëllim që familjet të mos mbeten në baltë. Rruga “Halil Haziri”, “Lagjja Piraj”, Koliç - rruga është trajtuar vetëm me zhavorr dhe është dëmtuar rëndë, në ç'rast kërkohet asfaltimi i plotë, pasi reshjet e dëmtojnë edhe më tej dhe e bëjnë të vështirë qarkullimin e banorëve. Në përfundim, kërkohet që të gjitha këto projekte, të cilat janë kërkesa të qytetarëve dhe presin zgjidhje prej vitesh, të trajtohen me prioritet dhe të përfshihen në Buxhetin e Komunës së Prishtinës për vitin 2027

Visar Dragidella - qytetar i Prishtinës: - thotë se para rreth dhjetë vitesh ka investuar në Marec, ku posedon tri objekte me leje ndërtimore, por nuk mund t'i shfrytëzojë për shkak të gjendjes së rrugës "Zaim Zeqa". Ai kërkon nga Komuna e Prishtinës asfaltimin e rrugës, duke theksuar se ajo shfrytëzohet edhe nga familje tjera, përfshirë familjen e një dëshmori. Sipas tij, vetëm një pjesë e rrugës është asfaltuar, ndërsa segmenti që çon te objektet dhe banorët mbetet i paasfaltuar. Dragidella thekson se ka investuar edhe në një depo për përpunimin e frutave të malit dhe në agroturizëm, por mungesa e rrugës e pamundëson funksionimin normal të këtyre investimeve, sidomos gjatë reshjeve. Ai shpreh shqetësim edhe për problemin e përroit, ndërhyrjet e pasuksesshme në urë dhe faktin se, pavarësisht kërkesave e premtimeve prej rreth dhjetë vitesh, rruga ende nuk është rregulluar. Ai u bën thirrje institucioneve ta vizitojnë zonën dhe kritikon procedurat e gjata administrative për lejet ndërtimore, duke vlerësuar se ato rëndojnë investimet rurale dhe shfrytëzimin e granteve. Po ashtu, ai përmend se ka hasur vonesa edhe në procedurat për një projekt të parkut solar, duke rrezikuar aplikimin për një grant evropian.

Avdi Deliu: - tha se në katër vitet e fundit, këshillat e lagjeve nuk janë ftuar në diskutime publike dhe nuk janë përfshirë në vendimmarrje nga Komuna e Prishtinës. Zona me mbi 15.000 banorë vazhdon të ketë mungesë të infrastrukturës arsimore dhe parashkollore, ndërsa investimet kanë qenë të kufizuara. Një shqetësim kryesor është kryqëzimi ndërmjet rrugës Prishtinë - Gjilan dhe rrugës për Pallatin e Drejtësisë, i cili konsiderohet shumë i rrezikshëm për shkak të mungesës së vijave të bardha për këmbësorë dhe organizimit jo të mirë të trafikut. Banorët detyrohen të ecin qindra metra për të kaluar rrugën, gjë që vështirëson lëvizjen sidomos për të moshuarit, fëmijët dhe personat me karroca. Në fund, folësi u bën thirrje drejtorëve të rinj komunalë që të shqyrtojnë kërkesat e qytetarëve dhe t'u përgjigjen problemeve të ngritura nga këshillat e lagjeve.

Sabedin Berisha - kryetar i Këshillit lokal të Llukarit, Makocit dhe Grashticës: - paraqiti disa kërkesa prioritare për këto fshatra. Ai kërkoj shtrimin dhe rihapjen e rrugëve të bllokuara, plotësimin e ndriçimit publik, rregullimin e shtratit të "Lumit Prishtevka" për të parandaluar vërshimet, si dhe largimin e rregullt të mbeturinave. Gjithashtu, ai kërkoj ndërtimin e një fushe sportive, zgjidhjen e problemit të mungesës së hapësirave në varreza, përmirësimin e ujësjellësit dhe kanalizimit, zgjerimin e rrugëve, si dhe vendosjen e pritoreve në stacionet e autobusëve. Në fund, ai theksoi se kërkesat më të detajuara do t'i dorëzojë me shkrim drejtorëve përkatëse.

Arbnor Neziri - Bashkësia Lokale Kalabria 2: - paraqiti nevojat kryesore të lagjes, të evidentuara së bashku me banorët në terren. Kërkesa kryesore është përfundimi i kolektorit, përfshirë pjesën nga Veterniku deri te Prishtina Stars dhe asfaltimin e pjesës së përfunduar deri te rruga "Dëshmorët e Ponushetit". Lagjja ka rreth 1.2 km rrugë të pashtuara dhe rreth 3 km rrugë me kubëza që kërkojnë asfaltim. Rrugët kryesore që kanë nevojë për ndërhyrje janë "Harun Aliu", "Dëshmorët e Ponushetit", "Agim Çelaj", "Rexhep Krasniqi" dhe "Sicilia". Gjithashtu kërkoj intervenim në 41 rrugica dytësore me gjatësi rreth 6 km. Problem i madh mbetet edhe mungesa e rrjetit të kanalizimit për rreth 2 km në disa pjesë të lagjes. Gjithashtu kërkoj vazhdimin e rrugës

“Ali Vitia” dhe lidhja me pjesën e Veternikut, duke shtuar se në ndriçimin publik ende mungojnë rreth 6 km rrugë të pandriçuara, kurse banorët kërkojnë zgjidhje edhe për problemet me mbushjen me ujë në nënkalimet pranë Olivit, spitalit dhe Termokosit. Parku te shkolla “7 Marsi” duhet të përfundojë, ndërsa nevojitet edhe një çerdhe e re publike për shkak të rritjes së lagjes. Këto janë disa nga kërkesat prioritare të banorëve të Kalabrisë 2, të cilat do të dërgohen edhe zyrtarisht me shkrim.

Isak Xhemali, përfaqësues i fshatit Sharban: - paraqiti problemet dhe kërkesat kryesore të banorëve. Ndër kërkesat prioritare tha se është përfundimi i rreth 1.5 km rrugicave të papërfunduara në Sharbanin e Ulët. Gjithashtu tha se mungojnë rreth 500 metra kanalizim, ndërsa një pjesë e rrjetit ekzistues është jofunksional, kurse problem mbetet edhe rreziku nga vërshimet, ku disa shtëpi mund të preken për shkak të mungesës së mbrojtjes së duhur të lumit. Ai kërkoi ndërhyrje në rrugicat e lagjeve “Brajshor dhe Alshiq”, me rreth 3 km rrugë që kanë nevojë për shtrim. Banorët kanë shqetësime edhe për menaxhimin e mbeturinave, pasi për disa javë nuk është bërë grumbullimi. Ndriçimi publik është rreth 70 % i dëmtuar dhe kërkon rehabilitim të plotë, kurse fshati ka nevojë edhe për lidhje me ujësjellësin nga zona e Halabakut për furnizim me ujë të pijshëm. Dy fushat sportive kanë nevojë për rregullim, sidomos rrethojat e dëmtuara të fushës në fund të lagjes, kurse varrezat e fshatit janë të parealizuara dhe kërkojnë rregullim e rrethim. Këto janë kërkesat kryesore të banorëve të Sharbanit që presin zgjidhje nga institucionet përkatëse.

Avni Osmani, kryetar i Këshillit lokal në Shkabaj: - paraqiti kërkesat kryesore të banorëve për drejtoritë përkatëse. Në arsim tha se kërkohet ndërtimi i shkollës së re “Dituria” dhe i një çerdheje. Për investime kapitale kërkohet vazhdimi i kolektorit drejt lagjeve “Kodra e Trimave” dhe “Arbëri”, si dhe rregullimi i rrugëve. Gjithashtu kërkoi renovimin e objektit të bashkësisë lokale. Në shëndetësi kërkoi renovimin e AMF-së në Shkabaj dhe zgjatjen e orarit të punës, kurse për shërbime publike kërkoi ndriçimin e rrugëve dhe rrugicave në lagje. Banorët kërkojnë rregullimin e parkut, mirëmbajtjen e hapësirave publike dhe vendosjen e lodrave për fëmijë, si kërkoi ruajtjen e linjës 6A të transportit publik dhe vendosjen e pritoreve. Gjithashtu kërkoi mirëmbajtjen e varrezave dhe hapjen e varreve. Ai theksoi se shumë kërkesa të protokolluara ndër vite nuk janë realizuar dhe kërkoi më shumë angazhim nga drejtoritë e reja. Ai theksoi se këto kërkesa janë të banorëve të Shkabajt dhe kërkoi që zëri i këshillave lokale të merret më seriozisht.

Labinot Gashi, banor i “Lagjes Velania”: - paraqiti disa kërkesa konkrete për përmirësimin e gjendjes në lagje. Ai kërkoi informatë për përfundimin e rrugës që lidh rrugën “1 Tetori” me rrugën “Isa Kastrati”, duke e vlerësuar si çështje urgjente. Nga Drejtoria e Parqeve kërkoi ndërhyrje në parkun te SOS Fshati, veçanërisht kositjen dhe mirëmbajtjen e hapësirave përreth ambulantës. Ai theksoi se bari i rritur paraqet shqetësim për sigurinë dhe mund të krijojë rrezik për banorët. Gjithashtu kërkoi që të merret parasysh shqetësimi i rrugëve pas punimeve që po

kryen KESCO për vendosjen e kabllave nëntokësore. Ai theksoi nevojën që punimet të përfundojnë si duhet dhe rrugët të kthehen në gjendje të rregullt. Këto ishin kërkesat kryesore të paraqitura për “Lagjen Velania”.

Milot Krasniqi, kryetar i Këshillit lokal Kalabria 1: - ngriti si problem kryesor mungesën e transportit publik në rrugën “Rexhep Krasniqi”, e cila është një nga rrugët kryesore të lagjes dhe rreth 2.5 km e gjatë. Ai kërkoi zgjidhje për furnizimin me ujë në rrugën “Baki Pacolli”, ku banorët kanë probleme që nga viti 2017, sidomos gjatë verës kur mbesin pa ujë për ditë të tëra. Një tjetër kërkesë ishte ndërtimi i një parku të ri pranë fakultetit të UBT-së ose afër Doganës, duke shfrytëzuar hapësirën e lirë ekzistuese. U kërkua zgjidhje për problemin e parkimit të rrethrotullimi i stacionit të autobusëve, ku veturat e parkuara në shiritat e qarkullimit krijojnë pengesa të mëdha. Ai përmendi edhe pengesat e vendosura në rrugën “Shefqet Shkupi”, të cilat janë shumë të larta dhe po shkaktojnë dëmtime të automjetet e banorëve.

Gëzim Sveçla - asamblist: - shprehu keqardhje për mungesën e kryetarit dhe nënkryetarëve në dëgjimet publike për buxhetin, duke theksuar se ata janë vendimmarrësit kryesorë. Ai vlerësoi kontributin e këshillave lokalë, të cilët paraqitën nevojat reale të qytetarëve, si rrugët, kanalizimi, shkollat, çerdhet, ndriçimi dhe menaxhimi i mbeturinave. Sveçla kërkoi sqarime mbi kriteret sipas të cilave projektet përzgjidhen për t’u përfshirë në buxhet, duke theksuar se shumica e kërkesave janë të realizueshme financiarisht dhe varen nga prioritetet e qeverisjes. Gjithashtu, ai ngriti shqetësime për cilësinë e dobët të investimeve publike, duke përmendur si shembull rrugën “Antigona Fazliu”, e cila, sipas tij, është në gjendje më të keqe pas renovimit. Në fund, ai kërkoi bashkëpunim më të madh me këshillat e lagjeve dhe trajtim serioz të kërkesave të tyre.

Dren Shahini - qytetar: - tha se po merr pjesë si qytetar, pasi ka dhënë dorëheqje nga pozita e kryetarit të bashkësisë lokale për shkak të mosadresimit të vazhdueshëm të kërkesave të lagjes. Ai theksoi se të gjitha kërkesat janë dorëzuar në drejtoritë komunale, por kanë mbetur pa përgjigje. Ai paralajmëroi se, nëse projektet e lagjes nuk përfshihen në buxhetin e vitit 2027, do të organizohen protesta për të kërkuar realizimin e tyre. Si prioritet përmendi rikonstruktimin e rrugëve “Muharrem Fejza” dhe “Kostandin Kristoforidhi”, si dhe zgjidhjen e problemeve me kanalizimin pranë shkollës “Pavarësia”. Në fund, ai kërkoi që lagjja të trajtohet me dinjitet dhe të marrë investimet e nevojshme.

Valbona Makolli - drejtoreshë në Drejtorinë e Financave: - falënderoi pjesëmarrësit për kontributin dhe sqaroi se të gjitha dëgjimet buxhetore regjistrohen dhe dokumentohen sipas kërkesave të ministrisë. Ajo theksoi se të gjitha kërkesat e paraqitura u përcillen drejtorive përkatëse dhe kabinetit, ku shqyrtohen dhe sipas mundësive buxhetore, përfshihen në buxhet, duke u evidentuar edhe projektet që tashmë janë planifikuar. Sa i përket buxhetit për vitin 2027, ajo bëri të ditur se, sipas përlllogaritjeve paraprake, Komuna e Prishtinës pritet të ketë rreth 61 milionë

euro buxhet, nga të cilat rreth 54 milionë euro janë të planifikuara për paga dhe mëditje, 34 milionë mallra dhe shërbime, 8 milionë subvencione, 3.8 komunalit dhe 57 milionë investime. Ajo tha se qarkorja përfundimtare ende nuk është publikuar, por planifikimet janë bërë bazuar në projektet që janë në vazhdim dhe përafërsisht do jetë ky buxhet.

Çlirim Gërbeshi - asamblist: - tha se, megjithëse u deklarua se kërkesat e qytetarëve shqyrtohen nga kryetari dhe drejtorët, në praktikë ato nuk merren parasysh, madje as kërkesat më bazike.

Valbona Makolli - drejtoreshë në Drejtorinë e Financave: - sqaroi se nuk kishte thënë që kërkesat nuk merren parasysh, por se ato regjistrohen, publikohen dhe shqyrtohen. Ajo theksoi se publikimi i tyre u mundëson edhe banorëve të tjerë të shohin kërkesat e paraqitura nga përfaqësuesit e tyre.

Isa Rexha - kryetar i Këshillit lokal Barilevë - Drenoc: - tha se projektet po u miratohen atyre që nuk marrin pjesë në dëgjimet publike, ndërsa kërkesat e përsëritura të bashkësisë së tij kanë mbetur pa realizim. Ai theksoi se në vitet 2024, 2025 dhe 2026 nuk është financuar asnjë projekt për lagjen, duke përmendur si shqetësime mungesën e çerdhes, rrugëve, kanalizimit dhe pengesave pranë shkollës, ku së fundmi ishte goditur nga një veturë një vajzë.

Arianit Elshani – drejtor në Drejtorinë e Arsimit: - sqaroi se për çështjet që lidhen me arsimin dhe ndërtimin e çerdheve është kërkuar konfirmimi i lokacioneve nga Drejtoria e Pronës, për të verifikuar statusin pronësor të parcelave. Ai bëri të ditur se, pas marrjes së këtyre konfirmimeve, lokacionet do të procedohen në Drejtorinë e Planifikimit Strategjik dhe më pas do të dërgohen për miratim dhe sigurim të financimit përmes programeve të ndryshme. Ai theksoi se të njëjtat procedura po ndiqen për disa zona, përfshirë Barilevën, Bardhoshin, Shkabajn, Diturinë, Nicin dhe Gorenjen, të cilat janë zona me rritje të vazhdueshme të popullsisë dhe kanë nevojë për hapësira të reja për çerdhe dhe objekte arsimore. Elshani tha se Drejtoria e Arsimit është duke i trajtuar këto kërkesa dhe do të vazhdojë procedurat sapo të marrë përgjigjet përkatëse nga drejtoritë tjera.

Avni --- (kryetar në Bashkësinë lokale Shkabaj): - kërkoi sqarim nga Drejtoria e Arsimit për shkollën “Dituria” në Shkabaj, duke theksuar se pas zgjidhjes së çështjes pronësore përmes marrjes me qira nga AKP-ja, janë krijuar mundësitë për ndërtimin e shkollës së re. Ai theksoi se ndërtimi i shkollës dhe i çerdhes duhet të trajtohen paralelisht, pasi të dyja janë nevoja të rëndësishme për zonën. Ai bëri të ditur se të dy kërkesat janë të protokolluara në Drejtorinë e Arsimit dhe kërkoi që komunikimi dhe bashkëpunimi me kryetarin e këshillit lokal të bëhet edhe përmes takimeve direkte, jo vetëm përmes email-eve, në mënyrë që kërkesat e komunitetit të trajtohen më afër.

Arianit Elshani - drejtor në Drejtinë e Arsimit: - sqaroi se për shkollën “Dituria” në Shkabaj, për shkak se objekti është me qira, nevojitet një përgjigje nga AKP-ja nëse lejohet realizimi i investimeve në atë pronë. Ai tha se kjo çështje do të trajtohet në planifikimet e Drejtorisë së Arsimit.

Avni ---- (kryetar në Bashkësinë lokale Shkabaj): - theksoi se është i informuar për këtë çështje dhe se komuna e ka marrë pronën me qira për 15 vite nga AKP-ja, me mundësi që më vonë të kalojë në pronësi të komunës. Ai u shpreh se ekzistojnë mundësitë ligjore për të vazhduar procedurat dhe për të realizuar investimet e nevojshme.

Çlirim Gërbeshi - asamblist: - tha se unë jam i bindur që me 12 milionë euro të një projekti korruptiv të dostave të kryetarit për projektin e arkitektit të kryeqytetit, shumica e këtyre problemeve ishin zgjidhur. Falemnderit.





Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



Dëgjimet publike lidhur me planifikimin e buxhetit për vitin 2027,
23.7.2026

Kryeqyteti - Prishtinë / Kuvendi Komunal

Nr.	Emri/Name	Mbiemri/Surname	Titulli/Title	e-mail	Nënshkrimi/Signature
1	Feim	OSMANI	anëtar kuvendi		
2	Glinim	Gjilbovli	Anëtar Kuvendi		
3	Gëzim	SVEGIA	-11-		
4	Avni	OSMANI	Këshill Lokal		
5	Enver	Redonov	Asamblet		
6	Isq	Beqir	Këshill Lokal		
7	DURIM	PERISHA	QYTETAR		
8	DREN	OHARINJ	ARTIVIST		
9	Regip	Lutoll	K.K.L. Arbrija2		
10	Deli	Arduci	KkL. Gogollari		

P.S *Të dhënat tuaja personale do të përdoren vetëm për qëllime të evidentimit të pjesëmarrësve në konsultim publik dhe nuk do të përdoren për qëllime tjera!

Pjesëmarrësit janë të njoftuar se gjatë diskutimeve publike, do të fotografohet dhe do të publikohen!

Nr.	Emri/Name	Mbiemri/Surname	Titulli/Title	e-mail	Nënshkrimi/Signature
11	Labimot	Gashi	Aktivist		
12	XHEMAZI	HALITI	FERMER		
13	Qorçaj	Lutet	TERNGER		
14	Pemzi	DEMOLLI	FERMER		
15	KALTRINA EXHEPATASANI	EXHEPATASANI	Fermere		
16	ASHAN DRAGUSTA	DRAGUSTA	Hës'mdhënës		
17	ISUF LORAHINI	Lorahini	Pensionist		
18	Boashkin / Boashkin	Boashkin	Tëpunës		
19	Sadudin Hasani	Hasani	Aktivist		
20	VISAR	DRACI DEXA	Aktivisi		
21	BISLIM	Sylor	K.B.L. Besi		
22	Riça	Gashi	Fermer		
23	Alum	Gashi	Fermer		
24	EVES	ABRAHIM	K.R. FSHATI		
25	SABEDIN	BERISHA	K. K. LOKAL		
26	ARCHOR	HEZIRI	K.L. "KLABRI 2"		
27	ISAK	XHEMAZI	Kryetar i Fsh. Shalban		
28	HYSEN MAKOLLI	MAKOLLI	Qytetarë		

P.S *Të dhënat tuaja personale do të përdoren vetëm për qëllime të evidentimit të pjesëmarrësve në konsultim publik dhe nuk do të përdoren për qëllime tjera!

Pjesëmarrësit janë të njoftuar se gjatë diskutimeve publike, do të fotografohet dhe do të publikohen!

Nr.	Emri/Name	Mbiemri/Surname	Titulli/Title	e-mail	Nënshkrimi/Signature
-----	-----------	-----------------	---------------	--------	----------------------

29	Ben Pakohia	agjenti			
30	Rousten xhafoll	-			
31	VJOSA SHKODRA	QYTETARE			
32	Nusret Kacuri	Gjyftuar			
33					
34					
35					
36					
37					
38					
39					
40					
41					
42					
43					
44					
45					
46					

P.S *Të dhënat tuaja personale do të përdoren vetëm për qëllime të evidentimit të pjesëmarrësve në konsultim publik dhe nuk do të përdoren për qëllime tjera!

Pjesëmarrësit janë të njoftuar se gjatë diskutimeve publike, do të fotografohet dhe do të publikohen!

Nr.	Emri/Name	Mbiemri/Surname	Titulli/Title	e-mail	Nënshkrimi/Signature
47					
48					
49					
50					
51					
52					
53					
54					
55					
56					
57					
58					
59					
60					
61					
62					
63					
64					

P.S *Të dhënat tuaja personale do të përdoren vetëm për qëllime të evidentimit të pjesëmarrësve në konsultim publik dhe nuk do të përdoren për qëllime tjera!
 Pjesëmarrësit janë të njoftuar se gjatë diskutimeve publike, do të fotografohet dhe do të publikohen!

Nr.	Emri/Name	Mbiemri/Surname	Titulli/Title	e-mail	Nënshkrimi/Signature
65					
66					
67					
68					
69					
70					
71					
72					
73					
74					
75					
76					
77					
78					
79					
80					
81					
82					
P.S *Të dhënat tuaja personale do të përdoren vetëm për qëllime të evidentimit të pjesëmarrësve në konsultim publik dhe nuk do të përdoren për qëllime tjera! *Pjesëmarrësit janë të njoftuar se gjatë diskutimeve publike, do të fotografohet dhe do të publikohen!*					